



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIË**

Nr. 4045/prot.

Tiranë, më 05.08.2019

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1487/1, datë 11.06.2013.

**SHOQËRISË “ERGIN - VEP” SH.P.K
Patin, Bashkia Klos, Qarku Dibër.**

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.**

Shoqëria “Ergin - Vep” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1487/1, datë 11.06.2013, për mineral kromi, në objektin “Brinja e Valit”, Bashkia Klos, Qarku Dibër.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së me shkresën nr.2590, datë 08.04.2019, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr.4045, datë 10.04.2019, është propozuar revokimi i lejes nr.1487/1, datë 11.06.2013, për mineral kromi, në objektin “Brinja e Valit”, Bashkia Klos, Qarku Dibër, sepse nuk keni paguar garancinë financiare të rehabilitimit të mjedisit për vitin 2018 - 2019, duke mos respektuar kërkesat e nenit 31 të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve, është i mbështetur në germen “ç”, pika 1, të nenit 47, (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet), të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1487/1, datë 11.06.2013, për mineral kromi, në objektin “Brinja e Valit”, Bashkia Klos, Qarku Dibër, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes shfrytëzimit nr.1487/1, datë 11.06.2013, për mineral kromi, në objektin “Brinja e Valit”, Bashkia Klos, Qarku Dibër.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI

BELINDA BALLUKU

ME AUTORIZIM

ZËVENDËSMINISTRI

HLIR BEJTJA

